

ÇFARË NËNKUPTOJNË TË DREJTAT THEMELORE PËR NJERËZIT NË BE?

PËRMBLEDHJE

ANKETË PËR TË DREJTAT
THEMELORE

2

Opinionet dhe njohuritë e njerëzve lidhur me të drejtat e njeriut

6

Këndvështrimet rreth funksionimit të shoqërisë demokratike dhe rreth pjesëmarrjes në politikë

12

Miradministrimi dhe korrupsioni në shërbimet publike

© European Union Agency for Fundamental Rights, 2021.

Riprodhimi autorizohet vetëm nëse tregohet qartë burimi.

Për çdo përdorim ose riprodhim të fotove apo materialeve të tjera, që nuk kryhet sipas të drejtave të autorit të Agjencisë së Bashkimit Evropian për të Drejtat Themelore, duhet të kërkohet leje drejtpërdrejt nga mbajtësit e të drejtave të autorit.

As Agjencia e Bashkimit Evropian për të Drejtat Themelore, as ndonjë person që vepron në emër të agjencisë, nuk është përgjegjës për përdorimin që mund t'u bëhet informacioneve të mëposhtme.

Luksemburg: Zyra e Publikimeve e Bashkimit Evropian, 2021.

Print	ISBN 978-92-9461-126-0	doi:10.2811/627991	TK-01-20-642-SQ-C
PDF	ISBN 978-92-9461-124-6	doi:10.2811/85774	TK-01-20-642-SQ-N

Burimi ku janë marrë fotografitë:

Kapaku: © iStock/filadendron

Faqja 5: © FRA

Faqja 6: © iStock/Vladimir Vladimirov

Faqja 10: © iStock/miodrag ignjatovic

Faqja 11: (majtas) © iStock/Chris Ryan; (djathtas) © iStock/Zolnierenk

Faqja 12: © iStock/notwaew

Faqja 13: (majtas) © iStock/Martinbowra; (djathtas) © iStock/urbazon

Faqja 16: © iStock/mediaphotos

Bashkimi Evropian është themeluar mbi vlerat e demokracisë, shtetit të së drejtës dhe respektit ndaj të drejtave të njeriut. Gjithsesi, këto vlera dhe diskutime rreth të drejtave themelore në nivelin e Bashkimit Evropian dhe të shteteve anëtare, mund të duken tepër larg në jetën e përditshme të njerëzve.

Duke pasur parasysh këtë, FRA eksploroj se çfarë kuptojnë, dinë dhe përjetojnë njerëzit në lidhje me të drejtat e tyre themelore të vëna në praktikë. Të dhënat rezultuese japin prova gjithëpërfshirëse dhe të krahasueshme në lidhje me këto aspekte.

Kjo përmbledhje paraqet njohuritë kryesore nga studimi i FRA. Synimi kryesor është të informohen institucionet e Bashkimit Evropian, qeveritë dhe institucionet e shteteve anëtare, si dhe mbrojtësit e të drejtave të njeriut dhe organizatat e shoqërive civile në lidhje me vendin që zënë të drejtat themelore në shoqëritë e Bashkimit Evropian – bazuar në opinionet dhe përjetimet e njerëzve.

Këto njohuri janë të domosdoshme për t'u lexuar nga ata që besojnë në politikëbërjen e bazuar në prova sipas parimit "nga poshtë lart". Personat puna e të cilëve lidhet me të drejtat themelore mund t'i përdorin të dhënat për të informuar dhe për të sfiduar supozimet e tyre lidhur me atë çfarë mendon dhe përjeton publiku.

Gjetjet mund të ndihmojnë gjithashtu për të ndërmarrë veprime të mirinformuara në lidhje me të drejtat e njeriut, dhe rrjedhimisht të përdoren për të pasur ndikim pozitiv në zbatimin e të drejtave në praktikë.

Shënim për terminologjinë

"Të drejtat themelore" është shprehja që përdoret për "të drejtat e njeriut" në kontekstin e brendshëm të Bashkimit Evropian. Në anketë, në disa pyetje është përdorur shprehja "të drejtat e njeriut", sepse të anketuarit e kishin më të lehtë ta kuptonin këtë term. Në këtë përmbledhje përdoren të dyja shprehjet.

Anketa për të drejtat themelore: fakte të rëndësishme

Anketa për të drejtat themelore ka grumbulluar të dhëna nga 29 shtete – 27 shtete anëtare të Bashkimit Evropian, Mbretëria e Bashkuar (e cila ishte shtet anëtar i Bashkimit Evropian në kohën e grumbullimit të të dhënave) dhe Maqedonia e Veriut (i vetmi shtet joanëtar i Bashkimit Evropian me status vëzhgues në FRA në kohën kur është hartuar anketa).

Në anketë u grumbulluan të dhëna nga gjithsej 34 948 të anketuar. Në secilin shtet morën pjesë si përfaqësues një numër të anketuarish – nga rreth 1000 persona në disa shtete deri në rreth 3000 persona në Francë dhe Gjermani.

Anketa për të drejtat themelore u krye online në Austri, Danimarkë, Estoni, Finlandë, Francë, Gjermani, Holandë, Luksemburg, Mbretërinë e Bashkuar dhe Suedi. Në shtetet e tjera, të intervistuarit u kontaktuan personalisht. Intervistat u kryen gjatë periudhës janar-tetor 2019.

Rezultatet janë rezultate përfaqësuese në nivelin e Bashkimit Evropian, si dhe për secilin shtet më vete, për sa u përket personave 16 vjeç e sipër që e kanë vendin e zakonshëm të banimit në vendin ku kanë marrë pjesë në anketë.

OPINIONET DHE NJOHURITË E NJERËZVE LIDHUR ME TË DREJTAT E NJERIUT

Shumica e njerëzve mendojnë se të drejtat e njeriut janë të rëndësishme për të krijuar një shoqëri më të drejtë, por personat që nuk janë mjaft të favorizuar në shoqëri, ka më pak të ngjarë të mendojnë se të drejtat e njeriut u sjellin dobi atyre.

OPINIONI 1 I FRA


Bashkimi Evropian dhe shtetet e tij anëtarë duhet të ndër marrin masa të posaçme për t'iu siguruar që personat që janë në vështirësi, të cilët ka më tepër të ngjarë të mendojnë se jo të gjithë gëzojnë të njëjtat të drejta themelore, të informohen mirë në lidhje me të drejtat e tyre dhe mënyrën si t'i kërkojnë ato. Gjithashtu, duhet të ndërmerren veprime për të ndihmuar në rritjen e ndërgjegjësimit për njerëzit që kanë nivele arsimore më të ulëta. Shtetet Anëtare të Bashkimit Evropian që implementojnë këto masa në nivel kombëtar, duhet të marrin parasysh përdorimin e mekanizmave të financimit në dispozicion të Bashkimit Evropian dhe përfshirjen e organeve kombëtare përkatëse, në veçanti Institucionet Kombëtare për të Drejtat e Njeriut, Organizmat e Barazisë dhe Institucionet e Mbrojtjes Civile.

Në këto masa duhet të përfshihen përpjekje për të komunikuar dhe promovuar të drejtat themelore, si dhe për t'i bërë ato të arritshme nga personat që janë titullarë të këtyre të drejtave. Shtetet Anëtare duhet të eksplorojnë forume dhe kanale të ndryshme për komunikim të efektshëm në lidhje me të drejtat, duke synuar grupe shoqërore të caktuara dhe duke përdorur mediat sociale krahas mediave të zakonshme, në bashkëpunim të ngushtë me organizatat e shoqërisë civile.

- ★ Pothuajse 9 në 10 persona (88%) në Bashkimin Evropian mendojnë se të drejtat e njeriut janë të rëndësishme për të krijuar një shoqëri më të drejtë në vendin e tyre. Kjo varion nga një nivel "i ulët" prej 76% në Hungari deri në një nivel "të lartë" prej 96% në Maltë. Përveç kësaj, pothuajse dy të tretat (64%) nuk janë dakord me pohimin se "të drejtat e njeriut nuk kanë asnjë domethënie për mua në jetën e përditshme". Kjo tregon se njerëzit në Bashkimin Evropian besojnë gjerësisht se të drejtat e njeriut mund të luajnë rol të dobishëm dhe kuptimplotë në jetën e tyre.
- ★ Në të njëjtën kohë, pothuajse 7 në 10 evropianë (68%) mendojnë se disa përfitojnë në mënyrë të padrejtë nga të drejtat e njeriut. Një e treta (33%) janë dakord me pohimin se "të vetmit njerëz që përfitojnë nga të drejtat e njeriut janë ata që nuk i meritojnë ato – si kriminelët dhe terroristët".
- ★ Rezultatet tregojnë se ekziston një lidhje mes të ardhurave e niveleve arsimore të njerëzve, dhe pikëpamjeve të tyre për të drejtat e njeriut. Njerëzit që thonë se kanë vështirësi të përmbushin nevojat financiare të familjes së tyre (pra kanë vështirësi të paguajnë gjërat e nevojshme), dhe ata me nivel arsimor fillor apo më të ulët, ka më pak të ngjarë të mendojnë se të gjithë njerëzit në vendin e tyre gëzojnë të njëjtat të drejta themelore. Ndërkohë, ata mendojnë gjithashtu se disa njerëz përfitojnë në mënyrë të padrejtë nga të drejtat e njeriut.
- ★ Për shembull, 44% e personave në vështirësi financiare janë dakord me pohimin se "të vetmit njerëz që përfitojnë nga të drejtat e njeriut janë ata që nuk i meritojnë ato, si kriminelët dhe terroristët". Në krahasim me ta, vetëm 27% e personave pa vështirësi financiare janë dakord me këtë pohim. Përveç kësaj, 38% e të moshuarve – 65 vjeç e sipër – janë dakord me këtë pohim, krahasuar me 27% të personave nga grupmosha 16-29 vjeç. Ndërkohë, 43% e personave me kufizime të rënda afatgjata në aktivitetet e tyre të përditshme, si personat me aftësi të kufizuara ose me probleme shëndetësore afatgjata, janë dakord me pohimin, krahasuar me 32% të atyre që nuk kanë kufizime të tilla.

- ★ Në 11 nga 27 shtete anëtare të Bashkimit Evropian, 50% ose më shumë janë dakord ose janë plotësisht dakord me pohimin se shkeljet e të drejtave të njeriut nuk janë vërtet problem në vendin e tyre, por janë një fenomen që ndodh në vende të tjera.
- ★ Ndarja e rezultateve sipas karakteristikave socio-demografike zbulon se njerëzit që arrijnë t'i plotësojnë nevojat financiare me "vështirësi" ose me "vështirësi të mëdha" ka më pak të ngjarë të jenë dakord (ose të jenë plotësisht dakord) me pohimin se abuzimet me të drejtat e njeriut nuk janë vërtet problem në vendin e tyre: 43% janë dakord me këtë, krahasuar me 54% të njerëzve që i plotësojnë nevojat financiare me "lehtësi" ose me "shumë lehtësi". Përveç kësaj, burrat janë më të prirur të kenë këtë mendim (52%) sesa gratë (44%).

FIGURA 1: PIKËPAMJET LIDHUR ME ASPEKTE TË CAKTUARA TË TË DREJTAVE TË NJERIUT (BE-27, %)



►
Shënime:
Nga të gjithë të anketuarit në BE-27 (n = 32 537); rezultatet e ponderuara.

Burimi: FRA, Anketa për të Drejtat Themelore 2019 [Grumbullimi i të dhënave në bashkëpunim me CBS (NL), CTIE (LU) dhe Statistics Austria (AT)]

“Estonia është përgjithësisht një shtet ku të drejtat e njeriut respektohen, por problemi është se, sipas mendimit tim, jetesa është e vështirë për njerëzit me të ardhura të pakta (pensionistët, njerëzit me aftësi të kufizuara).”

(Mashkull i moshës 16 deri në 29 vjeç, i anketuar në Estoni)

Në përputhje me axhendën e re strategjike për Bashkimin Evropian për vitet 2019–2024¹, ndërtimi i një Evrope të drejtë dhe sociale nëpërmjet implementimit të Shtyllës Evropiane të të Drejtave Sociale² – krahas “tranzicionit të drejtë” drejt një të ardhmeje të gjelbër³ – është prioritet kryesor për Bashkimin Evropian. Në dritën e këtyre angazhimeve, të jesh i papunë, të jetosh në varfëri dhe të jesh i përjashtuar nga shoqëria janë faktorë që nuk i lejojnë individët t’i gëzojnë plotësisht të drejtat e tyre.

¹ Këshilli Evropian (2019), *Një axhendë e re strategjike 2019-2024*.

² Parlamenti Evropian, Këshilli i Bashkimit Evropian, Komisioni Evropian, *Njoftimi Ndërinstitucional lidhur me Shtyllën Evropiane të të Drejtave Sociale*, Bruksel, 13 dhjetor 2017, Gazeta Zyrtare C 428. *Shtylla Evropiane për të Drejtat Sociale* mbulon 20 parime që sigurojnë të drejta të reja dhe më të efektshme për qytetarët e BE-së. Ajo përmban 3 fusha kryesore: mundësi dhe qasje të barabarta në tregun e punës; kushte të barabarta pune; dhe mbrojtje e përfshirje sociale (Parimi 3, për mundësitë e barabarta, përcakton se të gjithë kanë të drejtën të trajtohen në mënyrë të barabartë dhe të kenë mundësi të barabarta për sa i përket punësimit, mbrojtjes sociale, arsimit dhe qasjes në mallrat e shërbimet që janë në dispozicion për publikun).

³ Shiko Komisioni Evropian (2020), *Prezantimi i Mekanizmit për Tranzicionin e Drejtë – për një tranzicion të gjelbër të bazuar te solidariteti dhe drejtësia*.

Karta e të Drejtave Themelore e Bashkimit Evropian ka mjaft rëndësi në implementimin e ligjit të Bashkimit Evropian, dhe shumë prej të drejtave që parashikohen në këtë Kartë do të jenë të vështira të arrihen kur bëhet fjalë për grupet shoqërore dhe ekonomike më të marxhinalizuara në Bashkimin Evropian, gjë e cila reflektohet në përgjigjet e shumë pyetjeve të anketës. Disa prej të drejtave të Kartës janë me rëndësi të veçantë. Këtu përfshihet: dinjiteti i njeriut (neni 1); liria për të zgjedhur një profesion dhe e drejta për të punuar (neni 15); barazia mes grave dhe burrave (neni 23); mosdiskriminimi (neni 21); siguria sociale dhe asistencë sociale (neni 34); kujdesi shëndetësor (neni 35); liria e lëvizjes dhe e banimit (neni 45), për të përmendur vetëm disa.

E drejta për qasje në sistemin e drejtësisë (neni 47 i Kartës) është gjithashtu me rëndësi gjatë shqyrtimit të rezultateve të anketës. Qasja në sistemin e drejtësisë kompromentohet kur individët – sidomos ata që bëjnë pjesë në grupe të marxhinalizuara, si ata që nuk janë në gjendje të plotësojnë nevojat e tyre financiare – i perceptojnë mekanizmat e kontrollit të një sistemi si diçka të panjohur në jetët e tyre të përditshme, gjë e cila shoqërohet nga mungesa e njohurive lidhur me të drejtat dhe mënyrën se si ushtrohen ato.

Njohuritë rreth Kartës së të Drejtave Themelore të Bashkimit Evropian janë më të pakta sesa ato në lidhje me instrumentet e tjera ndërkombëtare për të drejtat e njeriut, dhe ndryshojnë në varësi të nivelit arsimor të personave.

OPINIONI 2 I FRA

Pas konkluzioneve të vitit 2019 nga Këshilli i Bashkimit Evropian lidhur me Kartën, shtetet anëtare të Bashkimit Evropian duhet të shqyrtojnë se si të japin "informacion sa më të aksesueshëm" për publikun në lidhje me të drejtat themelore të Kartës. Kjo do të mbështeste gjithashtu aktorët kombëtarë për të drejtat e njeriut në përpjekjet e tyre për të rritur ndërgjegjësimin dhe për të përmirësuar implementimin e Kartës.

Në promovimin e Kartës, Bashkimi Evropian duhet të mbështesë një shkëmbim të rregullt mes shteteve anëtare të Bashkimit Evropian lidhur me praktikën dhe mësimet e nxjerra për të arritur nivele të larta ndërgjegjësimi dhe njohurie lidhur me Kartën, sidomos në shtetet anëtare ku Anketa për të Drejtat Themelore tregon nivele të ulëta ndërgjegjësimi. Kjo mund të bëhet në kuadër të angazhimit ekzistues në nivelin e Grupit të Punës së Këshillit për të Drejtat Themelore, të Drejtat e Qytetarëve dhe për Lëvizjen e Lirë të Personave (FREMP) për të kryer një dialog të përvitshëm në lidhje me Kartën.

★ Një në dy persona (53%) ka dëgjuar për Kartën e të Drejtave Themelore të Bashkimit Evropian. Numri i atyre që kanë dëgjuar për Kartën ishte më i vogël sesa i atyre që kanë dëgjuar për Konventën Evropiane për të Drejtat e Njeriut dhe Deklaratën Universale të të Drejtave të Njeriut.

Ndoshta kjo gjetje është diçka që pritet, duke marrë parasysh se Konventa Evropiane për të Drejtat e Njeriut është krijuar më shumë se shtatëdhjetë vite më parë, ndërsa Karta e të Drejtave Themelore e Bashkimit Evropian është relativisht e re, pasi është miratuar njëzet vite më parë. Megjithatë, të dhënat tregojnë se hendeku mes njohurive të njerëzve për Kartën dhe atyre për KEDNJ është më i vogël në ato shtete që janë anëtarësuar në Këshillin e Evropës në vitet 1990, dhe ku KEDNJ është zbatuar për një kohë më të shkurtër.

★ Personat me nivel arsimor më të ulët ka më pak të ngjarë të kenë dëgjuar për ndonjë prej tre instrumenteve ndërkombëtare për të drejtat e njeriut, për të cilat u pyetën në anketë – Deklarata Universale e të Drejtave të Njeriut, Konventa Evropiane e të Drejtave të Njeriut, dhe Karta e të Drejtave Themelore e Bashkimit Evropian.

★ Përveç nivelit arsimor, karakteristika të tjera socio-demografike të asociuara me njohuri më të pakta rreth instrumenteve për të drejtat e njeriut ishin vështirësitë në plotësimin e nevojave financiare të familjes, moshën e madhe (65 vjeç e sipër) dhe të qenit i papunë ose në pension.


Karta është një prej instrumenteve më moderne dhe më gjithëpërfshirëse me fuqinë e ligjit lidhur me të drejtat e njeriut. Ajo ka të njëjtën vlerë me Traktatet e Bashkimit Evropian. Neni 51 i Kartës u kërkon shteteve anëtare të Bashkimit Evropian që, kur veprojnë brenda fushës së zbatimit të legjislacionit të Bashkimit Evropian, të respektojnë të drejtat, të zbatojnë parimet dhe të nxisin zbatimin e dispozitave të Kartës. Në **konkluzionet e Këshillit të Bashkimit Evropian të vitit 2019 për Kartën** u bëhet thirrje shteteve anëtare që të shtojnë numrin e aktiviteteve ndërgjegjësuese dhe trajnuese mbi Kartën mes aktorëve kryesorë të të drejtave të njeriut – duke pranuar rolin e FRA në këtë drejtim. Konkluzionet e Këshillit theksojnë gjithashtu rëndësinë për t'i siguruar publikut informacion të aksesueshëm rreth të drejtave që parashikohen në Kartë.

FIGURA 2: NDËRGJEGJËSIMI LIDHUR ME INSTRUMENTET KRYESORE TË TË DREJTAVE TË NJERIUT (BE-27, %)



Shënime:

Nga të gjithë të anketuarit në BE-27, të cilëve iu kërkua të plotësojnë seksionin "Ndërgjegjësimi dhe përgjegjësitë lidhur me të drejtat" të anketës (n = 24 354); rezultatet e ponderuara.



Burimi: FRA, Anketa për të Drejtat Themelore 2019 [Grumbullimi i të dhënave në bashkëpunim me CBS (NL), CTIE (LU) dhe Statistics Austria (AT)]



KËNDVËSHTRIMET RRETH FUNKSIONIMIT TË SHOQËRISË DEMOKRATIKE DHE RRETH PJESËMARRJES NË POLITIKË

Personat e rinj në moshë u japin më pak rëndësi sesa ata në moshë më të madhe aspekteve të funksionimit të shoqërive demokratike për të cilat u pyetën në anketë.

OPINIONI 3 I FRA

Për të rritur përfshirjen e të rinjve në funksionimin e shoqërisë demokratike, si shtyllë e rëndësishme për të gëzuar të drejtat themelore, Komisioni Evropian dhe shtetet anëtare duhet të marrin parasysh gjetjet e anketës – të cilat tregojnë se 16-29-vjeçarët i japin më pak rëndësi aspekteve të rëndësishme të demokracisë – gjatë implementimit të **Strategjisë së Bashkimit Evropian për Rininë 2019-2027**. Kjo strategji, në nivelin e Bashkimit Evropian, përfshin "rritjen e pjesëmarrjes së të rinjve në jetën demokratike, duke përfshirë qasjen në informacionet cilësore të verifikuara nga burime të besuara dhe nxitjen e pjesëmarrjes në zgjedhjet evropiane dhe në zgjedhjet e tjera". Është e rëndësishme që të rinjtë të përfshihen drejtpërdrejt në këtë proces.

Bashkimi Evropian dhe shtetet anëtare duhet të marrin parasysh modelet gjithnjë në zhvillim të përfshirjes politike të të rinjve dhe të eksplorojnë mënyra të reja për të përfshirë dhe për të komunikuar në mënyrë të efektshme me të rinjtë në Evropë.

- ★ 86% e njerëzve besojnë se zgjedhjet e lira dhe të ndershme janë shumë të rëndësishme për demokracinë. Në përgjithësi, tri në pesë persona ose edhe më shumë i japin rëndësi të madhe secilit prej gjashtë aspekteve të demokracisë, për të cilat u pyetën në anketë. Rezultatet variojnë nga 60% deri në 86%, në varësi të aspektit për të cilin u pyetën. (Për listën e plotë të pyetjeve, shihni kutinë.)
- ★ Të rinjtë e grupmoshës 16-29 vjeç u japin njëtrajtësisht një rëndësi më të vogël gjashtë aspekteve të demokracisë për të cilat u pyetën në anketë, krahasuar me grupmoshat më të mëdha. Për shembull, të rinjtë (58%) u japin më pak rëndësi çështjeve të tilla si liria e partive opozitare për të kritikuar qeverinë, sesa ata të grupmoshave më të mëdha (70% e personave të moshës 54-64 vjeç dhe 69% e personave të moshës 65 e sipër).
- ★ Neni 165 i Traktatit për Funksionimin e Bashkimit Evropian i kërkon Bashkimit që të marrë masa për të nxitur pjesëmarrjen e të rinjve në jetën demokratike në Evropë. Strategjia e Bashkimit Evropian për Rininë 2019-2027, e cila përbën kuadrin komunitar për pjesëmarrjen e të rinjve në politikë, nxit pjesëmarrjen e të rinjve në jetën demokratike, duke mbështetur njëkohësisht edhe përfshirjen e tyre sociale dhe civile. Përveç kësaj, **Rezoluta e Parlamentit Evropian e 15 janarit 2020 për Konferencën mbi të Ardhmen e Evropës** beson se sigurimi i pjesëmarrjes së të rinjve do të jetë pjesë thelbësore e ndikimeve afatgjata të konferencës, dhe kërkon që në këtë fushë të organizohen evente të caktuara rinore.



Çfarë pyetjesh u shtruan në anketë?


Sa të rëndësishme mendoni se janë për demokracinë aspektet e mëposhtme?

- Zgjedhjet të jenë të lira dhe të ndershme
- Votuesit t'i diskutojnë politikat me të tjerët para se të vendosin si të votojnë
- Partitë opozitare të jenë të lira të kritikojnë qeverinë
- Raportimet nga mediat të mos ndikohen nga qeveria
- Të drejtat e grupeve minoritare të jenë të mbrojtura

- Qytetarët të kenë rol vendimtar në çështjet më të rëndësishme politike, duke votuar për to në mënyrë të drejtpërdrejtë në referendume

Të anketuarit mund t'i përgjigjeshin secilës pike duke zgjedhur një vlerë nga "1 – Aspak e rëndësishme" në "7 – Shumë e rëndësishme". Gjithashtu, të anketuarve që nuk zgjidhnin asnjë prej këtyre kategorive të përgjigjeve, u jepej mundësia të përgjigjeshin me "preferoj të mos komentoj" ose "nuk e di".

FIGURA 3: RËNDËSIA QË I JEPET LIRISË SË PARTIVE OPOZITARE PËR TË KRITIKUAR QEVERINË NGA NJERËZIT E MOSHAVE 16-29 VJEÇ DHE 65 VJEÇ E SIPËR, SIPAS SHTETIT (%)^{a,b}



Shënime:

^a Nga të gjithë të anketuarit në BE-27, Mbretërinë e Bashkuar dhe Maqedoninë e Veriut, të cilëve iu kërkua të plotësonin seksionin "Ndërgjegjësimi dhe përgjegjësitë lidhur me të drejtat" të anketës (n = 26 045); rezultatet e ponderuara.

^b Të anketuarit mund t'i përgjigjeshin secilës pike duke zgjedhur një vlerë nga "1 – Aspak e rëndësishme" në "7 – Shumë e rëndësishme". Përveç kësaj, të anketuarve që nuk zgjidhnin asnjë prej këtyre kategorive të përgjigjeve, u jepej mundësia të përgjigjeshin me "preferoj të mos komentoj" ose "nuk e di". Rezultatet e mësipërme bazohen te përgjigjet e të anketuarve që kanë zgjedhur vlerën 6 ose 7 në shkallën e vlerësimit.

Burimi: FRA, Anketat për të Drejtat Themelore 2019 [Grumbullimi i të dhënave në bashkëpunim me CBS (NL), CTIE (LU) dhe Statistics Austria (AT)]

Njerëzit besojnë në parimet demokratike – por shumë syresh mund të ndihen “të lënë pas dore” nga politika konvencionale dhe politikanët.

OPINIONI 4 I FRA

Për të rritur pjesëmarrjen politike në Bashkimin Evropian, nevojiten përpjekje të përbashkëta për të adresuar gjetjen e anketës sipas së cilës shumica e njerëzve mendojnë se “partive konvencionale dhe politikanëve nuk u bëhet vonë për njerëzit si unë”, gjë që reflektohet edhe në gjetjen se njerëzit mendojnë që shanset e tyre për të gjetur punë janë më të pakta nëse nuk i përkasin partisë politike që është në pushtet. Bashkimi Evropian dhe shtetet anëtare duhet t’u kushtojnë vëmendje të veçantë grupeve të shoqërisë që ndihen më të distancuara nga proceset demokratike – si p.sh. njerëzit që kanë vështirësi me sigurimin e të ardhurave.

Dialogët me qytetarët dhe konsultimet përkatëse janë një mjet i konsoliduar angazhimi në Bashkimin Evropian për të përfshirë grupet e ndryshme të shoqërisë në çështjet e rëndësishme të politikës. Megjithatë, nevojitet një rishikim thelbësor i këtyre mjeteve për të përfshirë edhe personat me vështirësi ekonomike dhe për t’u angazhuar me ta në mënyrë sistematike.

Një shoqëri civile aktive, përkrah një medie të pavarur, pluraliste dhe të përgjegjshme, dhe e mbështetur nga liria e fjalës, ka nevojë për mbështetje në nivelin e Bashkimit Evropian dhe atë të shteteve anëtare për rolin që luan në rritjen e përfshirjes demokratike si mjet për të promovuar të drejtat themelore.

- ★ Shumica e njerëzve në Bashkimin Evropian (60%) janë dakord ose janë plotësisht dakord se partitë konvencionale dhe politikanët nuk duan t’ia dinë për ta.
- ★ Ndjesia se "partitë konvencionale dhe politikanët nuk interesohen për njerëzit si unë" është më e theksuar mes njerëzve që kanë vështirësi për të siguruar të ardhurat e nevojshme për familjen, mes atyre që janë me arsim të mesëm, si edhe mes njerëzve që vuajnë nga kufizime të rënda afatgjata në aktivitetet e përditshme (për shkak të aftësive të kufizuara ose problemeve shëndetësore afatgjata). Për shembull, 73% e njerëzve që e kanë të vështirë ose tepër të vështirë të sigurojnë të ardhurat e nevojshme për familjen, janë dakord me këtë pohim. Nga ana tjetër, vetëm 45% e atyre që janë në gjendje financiare të mirë ose shumë të mirë janë dakord me këtë pohim.
- ★ 63% mendojnë se njerëzit kanë më tepër shanse të gjejnë punë nëse i përkasin partisë politike që është në pushtet. Rezultatet tregojnë dallime të mëdha mes shteteve anëtare të Bashkimit Evropian për sa i përket shkallës në të cilën njerëzit janë dakord me këtë pohim. Duket qartë që këto mendime janë të zakonshme mes njerëzve që kanë vështirësi financiare.


Demokracia, së bashku me të drejtat e njeriut dhe shtetin e së drejtës, përbën një prej tri shtyllave kryesore të Bashkimit Evropian, dhe të tria bëjnë pjesë në vlerat themelore të Bashkimit, siç tregohet në pikën 2 të Traktatit për Bashkimin Evropian. Ndarja e pushteteve, liritë politike, transparencja dhe përgjegjshmëria janë parime të njohura në mbarë botën për një demokraci që është themeluar mirë dhe që funksionon mirë. Të drejtat e njeriut, ose të drejtat themelore – siç quhen në kontekstin e brendshëm të Bashkimit Evropian – janë çelësi për mirëfunksionimin e shoqërive demokratike në Bashkimin Evropian.

Programi "Evropa për Qytetarët" i Bashkimit Evropian, i cili ka si synim të përmirësojë kushtet për pjesëmarrjen civile dhe demokratike të shtetasve në nivelin e Bashkimit Evropian, është pjesë e rëndësishme e instrumenteve të Bashkimit Evropian për të nxitur përfshirjen demokratike. **Konferenca për të Ardhmen e Evropës** është një nismë demokratike mbarëevropiane, që ka si synim të arrijë një përfshirje më të efektshme të qytetarëve të Bashkimit Evropian. Ajo është një tjetër mekanizëm përmes të cilit Bashkimi Evropian përpiqet të përfshijë qytetarët në proceset demokratike, në harmoni me parimet e përcaktuara në Kartë që lidhen me të drejtat e qytetarëve, si e drejta për të votuar dhe për të kandiduar në zgjedhjet për anëtarë të Parlamentit Evropian (pika 39) dhe e drejta për të votuar dhe për të kandiduar në zgjedhjet bashkiake (neni 40).

“Të drejtat e njeriut vlejnë vetëm kur ke njohje në politikë. Njerëzit e thjeshtë janë të pambrojtur.”

(Femër e moshës 65 vjeç e sipër, e anketuar në Spanjë)

FIGURA 4: PIKËPAMJET LIDHUR ME POHIMIN “PARTIVE KONVENCIONALE DHE POLITIKANËVE NUK U BËHET VONË PËR NJERËZIT SI UNË”, SIPAS KARAKTERISTIKAVE TË PËRZGJEDHURA SOCIO-DEMOGRAFIKE (BE-27, %)^{a,b}



Shënime:

- ^a Nga të gjithë të anketuarit në BE-27, të cilëve iu kërkua të plotësojnë seksionin "Ndërgjegjësimi dhe përgjegjësitë për të drejtat" të anketës (n = 24 354); rezultatet e ponderuara.
- ^b Për hollësi rreth aspekteve socio-demografike që janë përdorur në analizë, shihni Shtojcën I në raportin kryesor.

■ Jam plotësisht dakord ose jam dakord ■ Jam neutral/e
■ Nuk jam aspak dakord ose nuk jam dakord ■ Nuk e di ose preferoj të mos komentoj

Burimi: FRA, Anketa për të Drejtat Themelore 2019 [Grumbullimi i të dhënave në bashkëpunim me CBS (NL), CTIE (LU) dhe Statistics Austria (AT)]

Një e katërta e njerëzve mendojnë se sistemi gjyqësor nuk është i pavarur, dhe një në pesë persona mendojnë se OJQ-të dhe organizatat bamirëse nuk janë kurrë të pandikuara nga qeveria.

OPINIONI 5 I FRA

Konstatimi se vetëm një e katërta e qytetarëve të Bashkimit Evropian mendojnë se gjykatësit në vendin e tyre nuk e kryejnë dot punën e tyre pa ndikimin e qeverisë – në disa shtete anëtare, këtë opinion e kanë një në dy shtetas – tregon se është e nevojshme të merren masa konkrete për të rritur besimin e publikut në pavarësinë e sistemit gjyqësor. Mungesa e këtij besimi kompromenton parimet e rëndësishme demokratike dhe të drejtat themelore, si e drejta për zgjidhje të efektshme dhe për gjykim të drejtë, si dhe e drejta për barazi dhe miradministrim.

Duke pasur parasysh se gjetjet e anketës tregojnë se një në pesë persona mendojnë se OJQ-të dhe organizatat bamirëse janë gjithnjë të ndikuara nga qeveria, është e domosdoshme që shtetet anëtare t'i respektojnë liritë dhe të drejtat e aktorëve të shoqërisë civile.

Bashkimi Evropian dhe shtetet anëtare duhet të grumbullojnë sistematikisht të dhëna të pavarura dhe të dobishme për opinionin publik lidhur me pavarësinë e sistemit gjyqësor, si edhe lidhur me aftësinë e OJQ-ve dhe organizatave bamirëse që të operojnë pa u ndikuar nga qeveria. Kjo do t'i sigurojë Komisionit dhe institucioneve të tjera të Bashkimit Evropian, si edhe shteteve anëtare, një bazë të dhënash plotësuese për përgatitjen e masave vijuese. Këto të dhëna mund të sigurojnë gjithashtu informacion mbi nisma të rëndësishme, si vlerësimi vjetor i kryer nga Komisioni për ekzistencën e shtetit të së drejtës në shtetet anëtare.

★ Një në katër persona (27%) në Bashkimin Evropian mendojnë se në shtetin e tyre, gjykatësit nuk janë "kurrë" ose janë "rrallëherë" në gjendje ta bëjnë punën e tyre pa u ndikuar nga qeveria. Rezultatet variojnë nga 47% në Kroaci në 11% në Danimarkë dhe Finlandë.

★ 37% e njerëzve në Bashkimin Evropian mendojnë se OJQ-të dhe organizatat bamirëse janë në shumicën e kohës ose gjithnjë në gjendje ta bëjnë punën e tyre pa u ndikuar nga qeveria. Ndërkohë, 34% mendojnë se kjo nuk është gjithmonë e vërtetë. Një në pesë persona (21%) besojnë se kjo nuk ndodh kurrë ose ndodh rrallë.

Në përputhje me nenin 47 të Kartës së të Drejtave Themelore të Bashkimit Evropian (e drejta për zgjidhje ligjore të efektshme dhe gjykim të drejtë), gjykatat e pavarura janë thelbësore për të garantuar mbrojtjen e efektshme gjyqësore të të drejtave themelore. Mbrojtja gjyqësore e efektshme, e cila është edhe e drejtë themelore edhe parim i përgjithshëm i legjisllacionit të Bashkimit Evropian, është një "shprehje konkrete" e shtetit të së drejtës, siç theksohet nga Gjykata e Drejtësisë e Bashkimit Evropian në jurisprudencën e saj në bazë të nenit 19, paragrafi 1 të Traktatit për Bashkimin Evropian – për shembull, në çështjen C-64/16, **Associação Sindical dos Juízes Portugueses** (vendimi i datës 27 shkurt 2018, paragrafi 32).


Asnjë demokraci nuk mund të lulëzojë pa praninë e një shoqërie civile aktive, siç theksohet edhe në Komunikatën e Komisionit për *Forcimin e shtetit të së drejtës brenda BE-së* – të publikuar në korrik 2019. Në këtë kontekst, Karta përfshin të drejtën e tubimit dhe të bashkimit (neni 12), dhe lirinë e shprehjes dhe të informimit (neni 11). Këto zbatohen për shtetet anëtare të BE-së kur ato veprojnë brenda fushës së zbatimit të legjisllacionit të BE-së, dhe janë veçanërisht të rëndësishme për nga mënyra se si lidhen me organizatat e shoqërisë civile në BE.

"Duhet të kesh lidhje të forta që të emërohesh gjykatës, ndaj ndikimi fillon që në këtë fazë."

(Femër e moshës 45 deri në 54 vjeç, pjesëmarrëse në fokus grup, Bullgari)



FIGURA 5: PERCEPTIMET NË LIDHJE ME AFTËSINË E GJYKATËSVE PËR TA BËRË PUNËN PA U DIKUAR NGA QEVERIA, SIPAS SHTETIT (%)^{a,b}



Shënime:

^a Nga të gjithë të anketuarit në BE-27, Mbretërinë e Bashkuar dhe Maqedoninë e Veriut të cilëve iu kërkua të plotësonin seksionin "Ndërgjegjësimi dhe përgjegjësitë lidhur me të drejtat" të anketës (n = 26 045); rezultatet e ponderuara.

^b Kategoritë e përgjigjeve që u përdorën në anketë ishin "Asnjëherë", "Rrallë", "Ndonjëherë", "Shumicën e kohës", "Gjithmonë", "Preferoj të mos komentoj" dhe "Nuk e di". Në figurë janë kombinuar disa prej kategorive fillestare të përgjigjeve, siç tregohet në emërtimet e kategorive.

Burimi: FRA, Anketa për të Drejtat Themelore 2019 [Grumbullimi i të dhënave në bashkëpunim me CBS (NL), CTIE (LU) dhe Statistics Austria (AT)]



MIRADMINISTRIMI DHE KORRUPSIONI NË SHËRBIMET PUBLIKE

Personat që kanë më tepër nevojë për një ofrim të mirë të shërbimeve nga administrata publike, si njerëzit me probleme shëndetësore afatgjata, theksojnë se përballen me vështirësi të veçanta.

OPINIONI 6 I FRA

Shtetet anëtare të BE-së duhet të sigurohen që informacioni për të drejtat e njeriut lidhur me shërbimet publike të jepet në kohë dhe të jetë i aksesueshëm nga të gjithë. Ato duhet t'i kushtojnë vëmendje të veçantë grupeve që kanë më tepër nevojë për këto shërbime – si njerëzit me probleme shëndetësore afatgjata ose me aftësi të kufizuara, duke përfshirë edhe të moshuarit.

- ★ Për sa u përket problemeve në marrëdhëniet me administratën publike dhe me autoritetet lokale, njerëzit shpeshherë shprehen se çështjet e tyre janë zvarritur në kohë dhe se kanë pasur vështirësi në marrjen e informacioneve të duhura.
- ★ Njerëzit që kanë kufizime afatgjata në kryerjen e aktiviteteve të tyre të përditshme (për shkak të aftësive të kufizuara ose problemeve shëndetësore afatgjata), si dhe njerëzit me arsim të ulët ose me të ardhura të pakta, e kanë më të vështirë të marrin informacion në lidhje me shërbimet e ofruara nga administrata publike dhe autoritetet lokale.

- ★ Një në dhjetë persona (11%) mendojnë se nuk janë trajtuar njëjloj me të tjerët nga administrata publike.

Për shembull, 17% e personave që i plotësojnë nevojat financiare me vështirësi ose me shumë vështirësi, besojnë se nuk janë trajtuar njëjloj me të tjerët nga administrata publike ose nga autoritetet lokale. Nga ana tjetër, vetëm 8% e personave që i plotësojnë nevojat financiare me lehtësi ose me shumë lehtësi ndajnë të njëjtin opinion.

- ★ Personat me kufizime të rënda afatgjata në kryerjen e aktiviteteve të përditshme (për shkak të aftësive të kufizuara ose problemeve shëndetësore afatgjata) ka më shumë të ngjarë të hasin probleme në lidhje me shërbimet e ofruara nga administrata publike dhe nga autoritetet lokale: 54% krahasuar me 39% për personat pa kufizime të tilla. Në mënyrë të ngjashme, personat që e kanë të vështirë të sigurojnë të ardhura për familjen ka më shumë të ngjarë të hasin probleme të tilla: 48% krahasuar me 39% për personat që i plotësojnë me lehtësi ose me shumë lehtësi nevojat financiare.



“Si nënë e një fëmije me aftësi të kufizuara, është e tmerrshme kur sheh se sa pak ndihmë dhe orientim merr në lidhje me të drejtat, mundësitë etj.”

(Femër e moshës 30 deri në 44 vjeç, e anketuar në Danimarkë)

Megjithatë, edhe mes personave me arsim të lartë vihet re një shkallë e lartë pakënaqësie nga shërbimet e ofruara nga administrata publike dhe nga autoritetet lokale, krahasuar me personat me arsim fillor ose më të ulët. Kjo gjetje tregon se pritshmëritë për ofrimin e shërbimeve janë më të larta mes njerëzve më të arsimuar.

E drejta për miradministrim, e shprehur në nenin 41 të Kartës, është një e drejtë themelore e cila është pjesë e rëndësishme e rendit juridik të Bashkimit Evropian. Si parim i përgjithshëm i të drejtës së BE-së, ajo ka fuqi detyruese edhe për shtetet anëtare, kur ato veprojnë brenda fushës së zbatimit të së drejtës së BE-së. Detyrimet e përgjithshme kombëtare burojnë gjithashtu nga Konventa Evropiane për të Drejtat e Njeriut (KEDNJ) dhe nga jurisprudenca përkatëse e Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut – veçanërisht në lidhje me konceptin e mirëqeverisjes. Sipas këtyre standardeve minimale, çdo person ka të drejtën që çështjet e ngritura prej tij të trajtohen në mënyrë të paanshme, të drejtë dhe brenda një kohe të arsyeshme nga autoritetet publike. Disa aspekte të tjera janë transparenca dhe marrja e informacionit, të cilat janë mjete të domosdoshme në mekanizmat kombëtare të kontrollit.

Roli i administratës publike dhe i autoriteteve lokale për t'i bërë informacionet të aksesueshme dhe të lehta për t'u kuptuar – një shërbim i domosdoshëm në rrethana normale – merr rëndësi parësore në situata të jashtëzakonshme, si pandemia e koronavirusit (COVID-19) e vitit 2020.

"Administrata publike punon tepër ngadalë. Ndonjëherë duhen javë për të marrë përgjigje për një kërkesë, dhe kur përgjigjja vjen, informacioni është pjesë-pjesë dhe është e pamundur të kuptohet."

(Mashkull i moshës 65 vjeç e sipër, i anketuar në Gjermani)





FIGURA 6: PËRBALLJA ME NJË OSE MË SHUMË PROBLEMATIKA NË MARRËDHËNIET ME ADMINISTRATËN PUBLIKE/AUTORITETET LOKALE GJATË PESË VITEVE PËRPARA ANKETËS, SIPAS KARAKTERISTIKAVE TË PËRZGJEDHURA SOCIO-DEMOGRAFIKE (BE-27, %)^{a,b,c}

■ Po ■ Jo



Shtënimet:

- ^a Nga të gjithë të anketuarit në BE-27, të cilëve iu kërkua të plotësonin seksionin "Eksperiencat e jetës së përditshme" të anketës (n = 26 493); rezultatet e ponderuara.
- ^b Kategoria "Po" tregon përqindjen e njerëzve që kanë hasur të paktën një prej gjashtë problemeve të renditura në anketë, në raportet me administratën publike dhe autoritetet lokale.
- ^c Për hollësi rreth aspekteve socio-demografike që janë përdorur në analizë, shihni Shtojcën I në raportin kryesor.

Burimi: FRA, Anketa për të Drejtat Themelore 2019 [Grumbullimi i të dhënave në bashkëpunim me CBS (NL), CTIE (LU) dhe Statistics Austria (AT)]

Në disa shtete anëtare, korrupsioni është më problematik se në disa shtete të tjera, dhe prek në veçanti sektorin e shëndetësisë. Gjysma e të rinjve mendojnë se ryshfeti në nivele të ulëta është i pranueshëm.

- ★ Fare pak njerëzve (4%) në Bashkimin Evropian u ka ndodhur që një zyrtar publik ose nëpunës civil t'u kërkojë ose të presë prej tyre një favor, si p.sh. një dhuratë ose donacion, në këmbim të një shërbimi të caktuar. Megjithatë, në disa shtete anëtare të Bashkimit Evropian, kjo është më e zakonshme, dhe numri i personave që përballen me këtë formë korrupsioni arrin deri në një në pesë persona.
- ★ Korrupsioni në lidhje me shërbimet shëndetësore konsiderohet një problem i veçantë. Në Hungari, Sllovakia, Kroaci dhe Letoni, mbi 60% e njerëzve shprehin se duhet të japësh, të paktën me raste, një dhuratë ose ndonjë lloj favor për të marrë trajtim më të mirë në spitalet shtetërore.
- ★ Megjithatë, një në katër persona (24%) besojnë se, ndonjëherë ose gjithmonë, është e pranueshme që t'i japësh një dhuratë një zyrtari publik ose një punonjësi civil për t'i përshpejtuar punët në raste urgjente. Mbi 50% e njerëzve në Sllovakia, Çeki dhe Kroaci, mendojnë se ndonjëherë, është e pranueshme t'i japësh dhurata ose favore një zyrtari publik ose punonjësi civil, në mënyrë që të veprojnë më shpejt në rastin e një kërkesë urgjente. Ndërkohë, Suedi, Maltë, Finlandë dhe Portugali, këtë mendim e ka vetëm 20% e popullsisë ose më pak.
- ★ Vihet re se 48% e njerëzve të grupmoshës 16-29 vjeç e shohin të pranueshme që të japësh një dhuratë ose favor, krahasuar me 35% për grupmoshat e tjera.

Korrupsioni cenon të drejtat themelore të Kartës, KEDNJ-së dhe instrumenteve të tjera ndërkombëtare të të drejtave të njeriut. Ai shkel veçanërisht parimet e barazisë dhe mosdiskriminimit (neni 20 dhe 21 i Kartës). Në varësi të sektorit, nga punësimi deri te shëndetësia, ai shkel edhe të drejta të tjera.

OPINIONI 7 I FRA

Lidhja mes shkallës së lartë të pranisë ose pranueshmërisë së korrupsionit dhe ndikimit të tij në të drejtat themelore të njerëzve – si akses i barabartë në shërbimet e administratës – duhet të njihet dhe të adresohet drejtpërdrejt nga administratat publike në BE. Kjo mund të arrihet duke u përqendruar te punonjësit e sektorëve të caktuar të rëndësishëm, siç është shëndetësia, ku ekziston një shkallë e lartë korrupsioni, dhe te grupet e popullsisë, si për shembull të rinjtë, të cilët duket se i pranojnë më shumë disa forma të caktuara të korrupsionit, duke theksuar paligjshmërinë e korrupsionit dhe të drejtat e njeriut për miradministrim dhe barazi në këtë aspekt.

Për ato shtete anëtare në të cilat anketa ka konstatuar një shifra më të larta të pranisë apo pranueshmërisë së korrupsionit, organet qeveritare – me mbështetjen e shoqërisë civile – duhet të bëjnë çdo përpjekje për t'i ulur këto shifra. Një mënyrë për të adresuar këtë është duke u siguruar që, në shpërndarjen e fondeve të BE-së, e në veçanti të Fondeve Evropiane Strukturore dhe të Investimeve, kushtet mundësuese të propozuara të përfshijnë një referencë ndaj nenit 41 të Kartës së Bashkimit Evropian për të Drejtat Themelore lidhur me të drejtën për miradministrim. Kjo duhet të monitorohet në mënyrë sistematike nga organet përkatëse të Bashkimit Evropian, si Gjykata e Auditesve dhe Zyra Evropiane kundër Mashtrimit (OLAF).


Duke pasur parasysh faktin se korrupsioni përbën një pengesë sistematike të konsiderueshme ndaj realizimit të të drejtave themelore, ai duhet të bëhet pjesë e përhershme e monitorimeve në kuadër të mekanizimit të ri evropian për shtetin e së drejtës – bazuar në prova të vlefshme dhe të krahasueshme. Kjo mund të kontribuojë në rolin e BE-së lidhur me organet ekzistuese që punojnë për të luftuar korrupsionin, veçanërisht në lidhje me grupin e shteteve të Këshillit të Evropës kundër korrupsionit (GRECO).

Në praktikë, të drejtat sociale cenohen më shpesh. Korrupsioni në sektorin e shëndetësisë cenon të drejtat e të gjithëve për sa i përket marrjes së shërbimit shëndetësor në standardet më të larta të mundshme (neni 35 i Kartës). Në sektorin e arsimit, rrezikohet e drejta për t'u arsimuar (neni 14 i Kartës). Nga ana tjetër, korrupsioni në sistemin gjyqësor cenon të drejtën për gjykim të drejtë dhe për zgjidhje ligjore të efektshme (neni 47 i Kartës), të cilat përbëjnë kusht për zbatimin e të gjitha të drejtave të tjera të njeriut dhe për parandalimin e pandëshkueshmërisë. Për më tepër, mungesa e një sistemi gjyqësor të pavarur sjell mosbesim ndaj institucioneve publike, duke kompromentuar respektimin e ligjit dhe demokracinë.

“Mjekët e spitaleve shtetërore presin gjithnjë t'u japësh dhurata që të kujdesen më mirë për ty.”

(Mashkull i moshës 16 deri në 29 vjeç, i anketuar në Qipro)

FIGURA 7: OPINIONET NË LIDHJE ME DHËNIEN E DHURATAVE OSE FAVOREVE PËR NJË ZYRTAR PUBLIK OSE NËPUNËS CIVIL NËSE NEVOJITET DIÇKA URGJENTE PREJ TYRE, SIPAS SHTETIT (%)



- E pranueshme ndonjëherë ose gjithmonë
- Nuk është asnjëherë e pranueshme
- Nuk e di ose preferoj të mos komentoj





Shënime:

Nga të gjithë të anketuarit në BE-27, Mbretërinë e Bashkuar dhe Maqedoninë e Veriut (n = 34 948); rezultatet e ponderuara.

Burimi: FRA, Anketa për të Drejtat Themelore 2019 [Grumbullimi i të dhënave në bashkëpunim me CBS (NL), CTIE (LU) dhe Statistics Austria (AT)]



Kjo përmbledhje paraqet gjetjet kryesore nga raporti i parë i FRA lidhur me anketën për të drejtat themelore. FRA ka publikuar edhe disa botime të tjera që paraqesin rezultatet e anketës. Këto mund të gjenden në faqen e internetit të FRA.






“PROMOVIMI DHE MBROJTJA E TË DREJTAVE TUAJA THEMELORE NË BASHKIMIN EVROPIAN” —

Kjo përmbledhje paraqet të dhënat kryesore të përfutuara nga raporti i parë i FRA, bazuar në anketën e saj për të drejtat themelore. Në anketë janë grumbulluar të dhëna nga rreth 35 000 persona lidhur me përvojat, perceptimet dhe opinionet e tyre në lidhje me një sërë çështjesh që prekin në mënyra të ndryshme të drejtat e njeriut.

Përmbledhja përqendrohet në rezultatet e nxjerra bazuar në opinionet e të anketuarve mbi të drejtat e njeriut ose të drejtat themelore; pikëpamjet dhe perceptimet e tyre lidhur me funksionimin e shoqërive demokratike – si një shtyllë që garanton respektimin e të drejtave të njeriut; si dhe mendimet e tyre rreth shërbimeve publike dhe përfshirjen e tyre me këto shërbime, të cilat kanë detyrimin të zbatojnë legjislacionin për të drejtat e njeriut dhe të mbrojnë të drejtat e njerëzve.



SUSTAINABLE DEVELOPMENT GOALS

FRA – AGJENCIA E BASHKIMIT EVROPIAN PËR TË DREJTAT THEMELORE

Schwarzenbergplatz 11 - 1040 Vjenë - Austri

T +43 158030-0 - F +43 158030-699

fra.europa.eu



facebook.com/fundamentalrights



twitter.com/EURightsAgency



linkedin.com/company/eu-fundamental-rights-agency



Publications Office
of the European Union